



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2019:238339

Datë: 12.03.2024

Numri i dokumentit: 05436859

C.nr.701/2023

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, si civile, gjyqtarin Hajrullah Aruqi me bashkëpunëtorin profesional Agron Geci, në çështjen juridike të paditësit J.I., nga fshati..., komuna Skenderaj, që e përfaqëson me autorizim Sh.I. avokat në Skenderaj, kundër të paditues Komuna Skenderaj, të cilën e përfaqëson E.Ç., për shpërblim të pagave jubilarë dhe pagave përcjellëse pas daljes në pension, jashtë seancës gjyqësore, me dt.12.03.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkespadija e paditësit J.I. nga fshati..., komuna Skenderaj.

II. DETYROHET e paditura Komuna Skenderaj që paditësit t'i paguaj tri (3) paga jubilarë në shumën prej 1,312.65 euro (njëmijë e treqind e dymbëdhjetë euro e gjashtëdhjetë e pesë cent) dhe dy (2) paga përcjellëse në shumën prej 875.01 euro (tetëqind e shtatëdhjetë e pesë euro e një cent), në shumën e përgjithshme prej 2,187.66 euro (dymijë e njëqind e tetëdhjetë e shtatë euro e gjashtëdhjetë e gjashtë cent), në afatin prej 7 dite nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

III. Secila palë i bart shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi me padin e ushtruar në gjykatë dt.23.10.2018 dhe me plotësimin e padisë me dt.30.04.2019 ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet e paditura t'i shpërblej dy paga përcjellëse dhe tri jubilarë në lartësin prej 2.187,66 euro me arsyetimin se, paditësi ka qenë zyrtar për... në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Skenderajt dhe me dt.04.05.2015 është pensionuar, e cila nuk i ka paguar tri pagat jubilarë dhe dy pagat përcjellëse siç është parapar në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës, ku kjo e drejt është parapar në nenin 52 dhe nenin 53 i kësaj Marrëveshjeje, andaj meqense paditësi i plotëson të gjitha kushtet sipas Ligjit të Punës dhe Kontratës Kolektive i propozoj gjykatës që padinë dhe kërkespadinë e paditësit ta aprovoj si të bazuar, si dhe i kërkoj shpenzimet e procedurës.

Në shqyrtimin kryesor të mbajtur me 10.02.2020 mbeti pranë padisë dhe precizimit të saj duke kërkuar që të detyrohet e paditura t'i paguaj tri paga jubilarë sipas pagës bazë prej 437,55 euro dhe dy pagat përcjellëse, më tutje shtoj se e kundërshton pretendimin e të paditueses se është kërkespadija është parashkruar, sepse me dt.01.05.2015 është pensionuar, ndërsa me dt.06.04.2018 ka parqitur kërkesë dhe se ka marrë përgjegjëje me dt. 11.04.2018 pa kaluar afat prej 3 vjetësh.

Nuk i kërkoj shpenzimet e procedurës kontestimore.

E paditura përmes përgjegjëjes në padi dhe deklarimeve në sëancë të shqyrtimit kryesor të dt.10.02.2020 e kundërshtoi në tërsi padin dhe kërkesen e saj me arsyetimin se, paditësi nuk i ka shterrur mjetet juridike siç parashef neni 50 par.1 dhe 2 i Ligjit për Sherbyesit Civil që më kohë të e kundërshtoj vendimin që ka realizuar vetëm një pagë përcjellëse. Më tutje shtoj se padia është paraqitë në gjykatë me dt. 30.04.2019 dhe është bazuar në Marveshtje Kolektive e cila ka hyrë në fuqi me dt. 01.01.2015 dhe ka skaduar me 31.12.2017, ku sipas nenit 90 kjo kontratë ka fuqi vetem 3 vjet, ndërsa paditësi ka dal në pension me dt.04.05.2015 dhe se padin e ka ushtruar me dt.30.04.2019, pas kalim të kohës prej 5 viteve që nënkuptohet se kërkespadija e ka arrit afatin e parashkrimit, sepse Kontrata e Përgjithshme Kolektive nuk ka fuqi retroaktive. Poashtu kjo gjykat nuk ka kompetencë lëndore për vendosje në këtë çështje ngase nuk i ka shterrur mjetet në procedurë administrative, i cili pasiqë ka qenë sherbyes civil ka qenë dashur t'i drejtohet Këshillit të Pavaruar Mbikqyres në Prishtinë, e më pastaj Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamentit për Çështje Administrative, andaj nga të lartcekurat i propozoj gjykatës që padin e paditësit ta refuzoj si të pabazuar.

Gjykata Themelore Mitrovicë – Dega në Skenderaj ka vendosur në këtë çështje juridike me Aktgjykimin C.nr.393/2018 të dt.25.02.2020 duke e aprovuar kërkespadinë e paditësit si të bazuar.

E paditura kundër Aktgjykimit C.nr.393/2018 të dt.25.02.2020 ka ushtruar ankesë me dt.01.06.2020 për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

Gjykata e Apelit në Prishtinë me Aktvendimin Ac.nr.4677/20 të dt.12.07.2021 e ka aprovuar ankesën e palës së paditur duke e prishur Aktgjykimin C.nr.393/2018 të dt.25.02.2020 të Gjykatës Themelore Mitrovicë – Dega në Skenderaj dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje duke e sygjëruar Gjykatën e shkallës së parë që të merren parasysh sygjërimet e shkallës së dytë fillimisht sa i përket kompetencës lëndore e pastaj të lëshohet në shqyrtimin e çështjes.

Gjykata Themelore Mitrovicë-Dega në Skenderaj me Aktvendimin C.nr.555/2021 të dt.08.02.2021 është shpallur jokompetent në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike pasi që paditësi është sherbyes civil dhe lënda me shkresa i është dërguar Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamentit për Çështje Administrative, e cila me Aktvendimin A.nr.898/2022 të dt.31.10.2023 ka hapur konfliktin e kompetencës pran Gjykatës së Apelit në Prishtinë.

Gjykata e Apelit në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative me Aktvendimin AN.nr.197/2023 e dt.12.12.2023 ka vendosur që kompetent në pikëpamje territoriale dhe lëndore për këtë çështje juridike është Gjykata Themelore Mitrovicë – Dega në Skenderaj.

Gjykata pas kthimit të lëndës në rishqyrtim dhe rivendosje nga Gjykata e Apelit, pas shqyrtimit të provave që gjinden në shkresat e lëndës, respektivisht menjaniut të dilemave sa i përket kompetencës lëndore, gjykata nuk vepron konform dispozitave të nenit 199 të LPK-së për caktimin e seancës gjyqësore, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se është mbajtur edhe shqyrtim gjyqësor në këtë çështje me dt.10.02.2020 dhe se ekzistojnë prova të mjaftueshme për të vazhduar pa seancë të shqyrtimit gjyqësor të mëtutjeshëm.

Gjykata me qëllim të konstatimit të drejt dhe të plotë të gjendjes faktike në çështjen konkrete juridike në kuptim të nenit 8 të LPK-së i nxori dhe i administroj të gjitha provat e shënuara në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor me dt.10.02.2020 një nga një dhe të gjitha së bashku duke i krahasuar njerën me tjetrën nga të cilat rezulton së kërkespadija e paditësit është e themelt.

Prej vendimit të lëshuar nga udhëheqesi i personelit pran Zyres së Kryetarit të Komunës në Skenderaj 03Nr.15148 dt.11.03.2015 konstatohet së paditësi është pensionuar me dt.04.05.2015 pas arritjes së moshes prej 65 vjet dhe në bazë të këtij vendimi e paditura ka marr për obligim që të shpërblej një pagë përcjellëse në lartësin prej 437.55 euro për shkak të arritjes së moshes së pensionimit tek punëdhënësi i fundit, i cili prej këtij vertetimit konstatohet se ka punuar tek e paditura si zyrtar profesional për...

Gjykata konstaton se paditësi pas daljes në pension e ka realizuar një pagë përcjellëse në shumën prej 437,55 euro.

Paditësi i ka shterrur mjetet juridike në procedurën administrative për realizim e dy pagave përcjellëse dhe tri pagave jubilarë që dëshmohet nga kërkesa drejtuar të paditës me nr. 02-120/02-0020947/18 e dt. 06.04.2018 dhe nga e paditura ka marrë përgjegjjen me dt.11.04.2018 duke u arsyetuar se në përputhje me Ligjin për Shërbyesit Civil ju ka paguar një pagë përcjellëse.

Në këtë çështje juridike kontestimore nuk është kontestues fakti se paditësi ka qenë në mardhënie pune tek e paditura deri me rastin e pensionimit, por si çështje kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse është moskompensimit për tri paga jubilarë dhe dy paga përcjellëse pas daljes në pension, të cilat paditësi pretendon se ka të drejtën e kompensimit, ndërsa e paditura e konteston këtë të drejt me pretendim se një e drejtë e tillë nuk i takon paditësit për arsye me rastin e daljes në pension nuk ka qenë në fuqi Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës dhe për shkak të parashkrimit të kërkesës.

Gjykata me rastin e vendosje të çështje konkrete juridike është bazuar në dispozitat e nenit 90 par.5 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 ku është përcaktuar se “Marrëveshja kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuar në Marrëveshje të tillë Kolektive”.

Gjykata bazuar në dispozitat e nenit 52 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, par.1 ku përcaktohet se “I punësuari ka të drejtë në shpërblimin jubilar:, ndërsa par.1.3 është përcaktuar se “për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë të punëdhënësi i fundit në vlerë të tri pagave mujore të tij”, ndërsa në dispozitat e nenit 53 është përcaktuar “I punësuarai , me rastin e pensionimit , gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësin prej tri (3) paga mujore, që i ka marrë për tre (3) muaj të fundit” e cila marrëveshje është e nënshkruar nga Partneret në Këshillin Ekonomiko – Social të Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi nga dt.01.01.2015, andaj në bazë të këtyre dispozitave ligjore paditësit ia njohi të drejtën e për dy pagat përcjellëse në shumën prej 875,01 euro, ndërsa për tri pagat jubilarë shuma prej 1,312.66 euro gjithësejt shuma prej 2,187.66 euro, duke marrë për bazë pagën e paditësit në shumën prej 437.55 euro të cilën pagë paditësi e ka realizuar deri me rastin e daljes në pension me dt. 04.05.2015 sa ka qen kjo kontratë në fuqi.

Gjykata sa i përket pretendiemve të palës së paditur se, Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive e cila ka qenë në fuqi prej dt.01.01.2015 dhe se e njëjta Marrëveshje nuk është në fuqi dhe se nuk ka fuqi prapavepruese, këto pretendime nuk qëndrojnë për faktin se pala e paditur nuk e ka përmbushur obligimin e saj ashtu siç është përcaktuar në nenin 52 par.2 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive ku “Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë”, ndërsa në par.3 është përcaktuar se “Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”, e që në rastin konkret pala e paditur e ka pasur obligim që ta paguaj detyrimin për pagesat e pagave jubilarë dhe pagave përcjellëse, e që sipas nenit 52 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive paga jubilarë nuk është e lidhur me pensionimin, por me kushtin e arritjes së vitit jubilar dhe me arritjen e kushtit jubilar lind edhe e drejta e cila nuk është përmbushur, e që në rastin konkret pala paditëse deri sa ka qenë në fuqi kjo marrëveshje i ka mbi tridhjetë vite përvoj pune dhe gëzon të drejtën e shpërblimit të tri pagave jubilarë, andaj pala paditëse me të drejtë ka kërkuar mbrojtje gjyqësore brenda afatit ligjor me parashtrimin e padisë në gjykatë, për faktin se iu ka mohua kjo e drejtë nga e paditura duke mos e përmbushur obligimin ashtu siç është përcaktuar në nenin 71 të Kontratës së Përgjithshme Kolektive se “Palët e MPKK, janë të obliguara, që ta zbatojnë dhe t’i respektojnë dispozitat e kësaj Marrëveshje Kolektive”.

Me nenin 245 të LMD-së është përcaktuar se “Kreditori në marrëdhëniet detyrimore ka të drejtë që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë përmbushjen e detyrimit në tërësi në përputhje me përmbajtjen e tij”, prandaj gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura i ka mbetur borxh paditësit me aplikimin e dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësit t’ia kompensoj borxhin në shumat e gjykuara.

Gjykata bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar si rezultat i provave të administruara erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e mbështetur ne faktet e vërtetuar me prova të administruar dhe e bazuar në dispozitat ligjore të lartpërmendura.

Sa i përket pretendimeve të palës së paditur se kërkesëpadia është parashkruar, gjykata pas krahasimit të këtyre pretendimeve më provat në shkresat e lëndës dhe dispozitat materiale të Ligjit

të Punës rezulton së kundërshtimet e saj nuk janë të mbështetura në fakte dhe prova, ngase paditësi se me dt. 04.05.2015 ka dalë në pension, ndërsa me dt.06.04.2018 iu ka drejtuar të paditurës me kërkesën për kompensimin dy pagave përcjellëse dhe tri pagave jubilarë, pra paditësi brenda afatit ligjor i është drejtuar të paditurës lidhur me kompensimin ashtu siç parashifet me dispozitat e nenit 87 të Ligjit të Punës ku është përcaktuar se “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”, ndërsa pas marrjes së përgjigjes nga e paditura me dt.11.04.2018, paditësi pas shterrjes së mjeteve juridike në procedurë admnistrative ka ushtruar padi në këtë gjykatë me dt.23.10.2018 duke kërkuar me të drejtë mbrojtje gjyqësore, prandaj kundërshtimet ndaj padisë nuk janë me ndikim që të vendoset ndryshe nga ajo që u vendos në dispozitiv të aktgjykimit.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës kontestimore gjykata vendosi në bazë të nenit 450 të LPK-së, ndërsa paditësi është liruar nga pagesa e taksave gjyqësore konform nenit 8.1.4 dhe 8.3.4 të Udhëzimit Administrativ nr.1/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore 01/88 të dt. 22.03.2018.

Me sa u tha me lart konform të nenit 143 të LPK-së dhe dispozitave materiale të cituara me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM.
C.nr.701/2023, me dt.12.03.2024**

**G j y q t a r i
Hajrullah Aruqi**

UDHËZIMË JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 7 dite nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, nëpërmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.